



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2010/2011.

TESTI 2

# MATEMATIKË

## UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testi të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra. Për zgjidhjen e këtij testi janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë më të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkosh pjesët e përgjigjesh, të shkruash diçka etj.

Ki kujdes për mënyrën se si duhet të përgjigjesh. Gjatë punës mund të përdorësh gomën, vizoren, trekëndëshin dhe kompasin. Nuk guxon ta përdorësh telefonin/celularin dhe kalkulatorin (digitronin).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.

Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.

Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se që e dorëzon testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaj me stilolaps. Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë. Nëse e vëren se dikund ke gabuar asaj detyre hiqi vizë, dhe shkruaje qartë cila përgjigje mendon se është mirë.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

**Të dëshirojmë sukses në provim!**



**1.** Rretho shkronjën para rendit në të cilin janë radhitur numrat nga më i vogli deri te më i madhi.

a)  $-\frac{4}{9}, -\frac{5}{9}, \frac{1}{9}, \frac{2}{9}$

b)  $-\frac{5}{9}, -\frac{4}{9}, \frac{1}{9}, \frac{2}{9}$

c)  $-\frac{5}{9}, -\frac{4}{9}, \frac{2}{9}, \frac{1}{9}$

d)  $\frac{1}{9}, \frac{2}{9}, -\frac{4}{9}, -\frac{5}{9}$

**2.** Llogarit dhe shkruaj rezultatin përkatës.

a)  $1,08 + 2,33 =$

b)  $1,08 - 2,33 =$

c)  $0,6 \cdot 3,2 =$

d)  $2,4 : 6 =$

**3.** Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Prodhimi  $2^{10} \cdot 2^2$  është i barabartë me:

a)  $2^5$

b)  $2^8$

c)  $2^{12}$

d)  $2^{20}$

4. Plotëso tabelën me vlerat përkatëse.

$x$	0	-2	4	0,5
$y = -\frac{1}{2}x + 2$				



5. Shenja rrugore në fotografi ka formë rrethore, dhe e tregon pjesën e rrugës në të cilën është e ndaluar lëvizja e këmbësorit.  
Sa është sipërfaqja e kësaj shenje rrugore nëse rrezja e saj është 30 cm?




Sipërfaqja e shenjës rrugore është \_\_\_\_\_ cm<sup>2</sup>.



6. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a)  $11,5 \text{ cm}^2$
- b)  $42,5 \text{ cm}^2$
- c)  $50 \text{ cm}^2$
- d)  $85 \text{ cm}^2$




7. Cilën njësi matëse e përdor për matjen përkatëse?  
Lidhi sipas shembullit të dhënë:

- |   |                 |
|---|-----------------|
| kohëzgjatja e pushimit në shkollë •               | • minutë        |
| largësia midis Somborit dhe Vranjës •             | • shkallë       |
| vëllimi i lëngut në shishen e ujit •              | • $\text{m}^2$  |
| masa e njeriut •                                  | • $\text{cm}^3$ |
| gjatësia e fletores •                             | • kilometër     |
| sipërfaqja e dhomës •                             | • centimetër    |
| këndi midis akrepit të orës dhe minutave në orë • | • kilogram      |


8. Cili nga numrat e dhënë është më i afërt me numrin 12,452?  
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 12,40
- b) 12,45
- c) 12,46
- d) 12,50

9. Në grafikon është pasqyruar numri i ditëve me shi gjatë 6 muajve të parë të një viti.

a) Në cilët muaj ka pasur më shumë se 11 ditë me shi?


b) Në cilët muaj ka pasur më pak se 10 ditë me shi?



a) Më shumë se 11 ditë me shi kanë qenë në \_\_\_\_\_.

b) Më pak se 10 ditë me shi kanë qenë \_\_\_\_\_.

10. Me grafikon është pasqyruar sa luleshtrydhe ka mbledhur secili punëtor. Lexo të dhënat nga grafikoni dhe shënoji në tabelën e dhënë.



Punëtori	Sasia e luleshtrydheve në kg
Merita	
Arti	
Floriani	
Kaltrina	
Dritoni	
Drita	

- 11.** Në 500 g të përzierjes së çajit  $\frac{1}{10}$  është mendër,  $\frac{3}{4}$  është balsam, kurse pjesa tjetër është çaj kamomileje. Sa gramë kamomileje janë në atë përzierje çaji?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 65 g
- b) 75 g
- c) 85 g
- d) 95 g

- 12.** Janë dhënë binomet  $M = -4m - n$  dhe  $N = 2m + 7n$ . Thjeshtëso shprehjen.


a)  $M + N =$

b)  $M - N =$

c)  $M \cdot N =$

- 13.** Sa është këndi i jashtëm  $\gamma_1$  i cili i përgjigjet kulmit  $C$  të katërkëndëshit  $ABCD$  në fotografi?  
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a)  $42^\circ$
- b)  $52^\circ$
- c)  $62^\circ$
- d)  $72^\circ$



- 14.** Naimi shkon në ekskursion në Vjenë. Rruga dhe qëndrimi i kushtojnë 400 euro dhe i paguan në gjashtë këste të barabarta. Çfarë shume duhet të paguajë Naimi në dinarë për këstin e parë, nëse në ditën e pagimit një euro e ka pasur vlerën 105 dinarë?

Naimi për këstin e parë duhet të paguajë \_\_\_\_\_ dinarë.

- 15.** Në bazë të koordinatave të dhëna të pikës  $A$  vizato në sistemin koordinues pikën  $M(-2, 3)$ .




- 16.** Për sa është vëllimi i prizmit të rregullt trifaqësh tehu bazë i të cilit është 6 cm dhe lartësia e prizmit 4 cm, më i madh se vëllimi i piramidës së rregullt trifaqëshe tehu bazë i të cilit është 6 cm dhe lartësia e piramidës 4 cm?  
Tregoje procedurën.

Vëllimi i prizmit është më i madh për \_\_\_\_\_  $\text{cm}^3$ .



- 17.** Në parkun “Kopshti ynë” malësorët i kanë mbjellur 1800 trungje të lisit. Gjatë vitit të parë janë prerë 16% të trungjeve të lisit nga ky park. Sa trungje të lisit kanë mbetur në park? Tregoje procedurën.

Në park kanë mbetur \_\_\_\_\_ trungje të lisit.

- 18.** Llogarite vlerën e shprehjes.

$$10 \cdot (0,096 - 0,069) - \frac{2}{9} \cdot \frac{5}{8} \cdot \frac{9}{5} + \frac{2}{9} \cdot \left(0,125 + \frac{1}{2}\right) : \frac{5}{9}$$

Tregoje procedurën.

Vlera e shprehjes është \_\_\_\_\_.

- 19.** Për cilët numra natyralë  $x$  është shprehja  $1 - \frac{5 - 2x}{10}$  më e madhe se shprehja  $\frac{2x - 5}{6}$ ?  
Tregoje procedurën.

$$x \in \{ \underline{\hspace{10cm}} \}$$



- 20.** Pishina e shkollës e ka formën e kuboidit dhe është i gjatë 8 m, i gjerë 5 m dhe i thellë 2 m. Për çdo vit shkollor kujdestari i pishinës i mbush me ujë shtatë të tetat e pishinës. Për mbajtjen e pastërtisë së ujit në pishinë kujdestari i përdor tabletat e klorit. Sipas udhëzimit ai duhet që në 5 000 l ujë të hedhë 2 tableta një herë brenda një muaji. Një tabletë e klorit kushton 27 dinarë. Sa do të paguajë shkolla për tabletat e nevojshme gjatë një muaji?  
Tregoje procedurën.

Shkolla do të paguajë tabletat e klorit \_\_\_\_\_ dinarë.

# Rezultati në testin e matematikë

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!  
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E paplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Komisioni:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

Shkruaj ✗ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	